

ALBAUTOR

110

AGJENCIA E ADMINISTRIMIT KOLEKTIV PËR TË DREJTËN E AUTORIT

STATUTI



14.02.19.2012  
VERTETOHET NJSMA ME  
ORIGINALIN FQ (...)  
SEKRETARE REGISTRIT

Besleme

her

## Neni 1

### Themelimi, Kohëzgjatja, Selia

“ALBAUTOR” është një organizatë jofitimprurëse me anëtarësi, me kohëzgjatje të pakufizuar dhe me seli në Blv. “Bajram Curri”, nr. 114, kati 2, Tiranë, Shqipëri.

Kjo shoqatë bazohet në: Ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jo fitimprurëse”; Ligjin nr. 8789, date 07.05.2001 “Per regjistrimin e organizatave jo fitim prurese”; dhe në përputhje me ligjin 35/2016 “Për të drejtat e Autorit dhe të Drejtat e lidhura me to”.

Ajencia është e pajisur me vulë në formë katrore me gërmë kapitale ALBAUTOR, e cila përdoret në cdo shkresë të Agjencisë dhe administrohet nga Drejtori i Agjencisë.

## Neni 2

### Qëllimi

1. Qëllimet e Agjencisë të administrimit kolektiv për mbrojtjen e autorëve “ALBAUTOR” janë:

- a) Mbledhja e të ardhurave për përdorimin e veprave në fushën e të drejtës të autorit dhe shpërndarjen e tyre tek titullarët e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, të cilët ia kanë kaluar këto të drejta për administrim Agjencisë.
- b) Sigurimin dhe administrimin e licensës së Agjensisë Kolektive për të drejtat e autorit në Republikën e Shqipërisë në përputhje me ligjin në fuqi “Për të drejtat e Autorit dhe të Drejtat e lidhura me to”;
- c) T'u japid përdoruesve, në vijim të kërkesave të tyre, kontrata dhe/ose autorizime në formën joekskluzive për përdorimin e veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura, në këmbim të një shpérblimi, me konratë të shkruar, brenda tagrave të përcaktuar në licencën e agjencisë;
- d) Harton rregulla për shpërndarjen e të ardhurave sipas vendimeve të organeve vendimarrëse. Sipas rregullores së brendshme e cila bën pjesë në këtë statut, sipas vendimit të Këshillit të Administrimit, rregulla të cilat janë në përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe detyrimet që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare në të cilat RSIT është palë, si dhe nga rregullat e shpërndarjes së CISAC (Confédération Internationale des Sociétés D'auteurs et Compositeurs – Konfederata Ndërkombëtare e Organizatave të Autorëve dhe Kompozitorëve);
- e) Hartimin e metodologjisë të tarifave të shpérblimit bazuar në ligjin në fuqi për të drejtën e autorit;

112

- f) Zhvillimin e aktivitetit të saj në dobi të të gjithë autorëve dhe jo grupeve të veçanta të tyre;
- g) Të kryejë veprimtarinë e vetë, me integritet, transparencë dhe efikasitet;
- gj) Të përshtatet për të adoptuar praktikat më të mira në fushën e administrimit kolektiv dhe të përshtatet me zhvillimet e vazhdueshme të tregut dhe të zhvillimeve teknologjike.
2. ALBAUTOR ka për qëllim integrimin dhe luajtjen e rolit aktiv në strukturat ndërkontinentale që funksionojnë në këtë fushë.
3. ALBAUTOR ka si qëllim analizën, mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave kulturore, profesionale dhe morale të anëtarëve të vet.
4. Të ndikojë, e të punojë në sensibilizimin e institucioneve e organizmave shtetërorë, private për: kujdesin, mbështetjen, inkurajimin, që duhet t'u japë të gjithë autorëve.
5. Të lidhë marrëveshje dhe kontrata me organizata homologe jashtë vendit përfaqësim reciprok.
6. ALBAUTOR ka qëllim vodosjen e rregullave konkretë në zbatimin e ligjit për të drejtat e autorit, legjislacionin tatimor si edhe në cdo ligj tjeter i cili në të ardhmen do të regullojë këtë veprimtar, duke krijuar kushtet për një konkurrencë të ndershme në treg ndërmjet anëtarëve të saj.
7. ALBAUTOR garanton trajtim të barabartë për mbajtësit e të drejtave, merr parasysh parimin e transparencës, parimin e konfliktit të interesit në organet e tyre drejtuese, si dhe parimin e mosdiskriminimit midis anëtarëve dhe joanëtarëve, si dhe përdoruesit e cdo lloji.
8. Të sigurojë transparencën e veprimtarisë së agjencisë së administrimit kolektiv përkundrejt autorëve, përdoruesve, si dhe në lidhje me autoritetet publike të kontrollit, sipas ligjit;
9. Të përfaqësojë mbajtësit e të drejtave, të drejtat e të cilëve ata administrojnë, në procedurat gjyqësore ose administrative dhe të kryejnë çdo veprim tjeter ligjor të nevojshëm për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të administruara nga ato;

### Neni 3

#### Kapitali i Agjencisë, të ardhura, shpërdarjet dhe shpenzimet

3.1 Kapitali i Agjencisë është i ndryshueshëm.

3.2 Burimet potenciale dhe pasurore janë:

1. Kuota e pranimit të anëtarëve, në masën e vlerësuar nga Këshilli i Administrimit,
2. Të ardhurat e krijuara nga përdorimi i pronësisë intelektuale në fushën e të drejtës të



- 113
- a. autorit bazuar në kontratat e lidhura me anëtarët vendas apo të huaj
  - 3. Kontributet ose subvensionet e Enteve Publike ose Private shqiptare dhe të huaja, nga dhurimet, kuotat, akte të vullnetshme dhe dhuruese, ose nga aktivitete të tjera në mbështetje të Shoqatës.
  - 4. Të tjera burime në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3.3 Shpërndarja e të ardhurave kryhet sipas ligjit në fuqi në bazë të deklarimit të përdorimit dhe Rregullores së Shpërndarjes. Përcaktimi i shumave që duhet të paguhen pas zbritjes së kostos për administrimin e së drejtës, ndarja e fondevë të parashikuara nga ligji, nga ky statut apo nga kontratat ndërkombëtare *për përfaqësimin e përbashkët* kryhet me vendim të Këshillit të Administrimit.

3.4 Shpenzimet totale të agjencisë "Albautor" nuk mund të përbëjnë më shumë se 30 përqind të shpërblimeve të shpërndara. *Shuma e përgjithshme e shpenzimeve të një shoqate apo çdo forme tjetër juridike OJF-je* do të përfshijë edhe mjetet financiare të shpenzuara në përmirësimin e sistemit të administritmit dhe mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe të të drejtave të lidhura me të. Përveç shpenzimeve të tillë të bëra, organet e agjencisë mund të vendosin për të shpenzuar maksimumi 3 përqind të shumës totale të shpërblimeve të grumbulluara mbi masat kundër piraterisë dhe falsifikimit, si dhe për masat e tjera që kanë përqëllim rritjen e ndërgjegjësimit të vlerës së të drejtës së autorit dhe të të drejtave të lidhura me të.

3.5 Tarifat e shpërblimeve të mbledhura nga përdoruesit, të cilat në përfundim të vitit finanziar nuk shpérndahen nga AAK-ja, depozitohen në një fond special për llogari të ministrisë përgjegjëse për të drejtat e autorit, në dispozicion të titullarëve të të drejtave të autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me to për një periudhë 3-vjeçare. Gjatë kësaj periudhe, nëse AAK-ja identifikon mbajtësin e së drejtës, siguron shpërndarjen dhe përfiton edhe tarifën e administrimit. Në rast se mbajtësi nuk identifikohet për një periudhë tre vjeçare, fondi special i kalon ministrisë përgjegjëse për të drejtat e autorit, e cila do ta përdorë në përbushje të objektivave të saj përritjen e krijimtarisë dhe diversitetin kulturor.

3.6 Përcaktimi i kriterieve dhe procedurës së shpërblimeve, me qënim stimulimini mbajtësve të të drejtave, veprat e të cilëve përfaqësojnë një vlerë të veçantë për kulturën dhe krijimtarinë kombëtare, kryhen me vendim të Këshillit të Administrimit e të miratuara paraprakisht nga KKDA-ja dhe llogariten mbi vlerën 30% të kostos së administrimit.

**Neni 4**  
**Anëtarësia**

14

1. Anëtarësimi në Agjenci është vullnetar dhe i hapur për të gjithë personat madhorë, me zotësi për të vepruar dhe gëzojnë cilësinë e titullarit të të drejtave.
2. Anëtarët e Agjencisë në momentin e anëtarësimit pranojnë në parim të drejtën e Agjencisë për mbrojtjen e të drejtave të tyre të autorësisë sipas rregullave të përcaktuara në këtë statut.
3. ALBAUTOR do të administrojë të drejtat e autorëve vetëm në bazë të një kontrate të lidhur me autorin. Kontrata do të përfshijë, në veçanti, autorizimin e autorit për administrimin e të drejtave të tij, llojin e veprave dhe të drejtave për t'u administruar dhe kohëzgjatjen e kontratës, e cila nuk duhet të kalojë tre vite, e rinovueshme.
4. Anëtarët e Agjencisë paguajnë kuotizacion vjetor sipas kuotës së vendosur nga Asambleja e Përgjithshme.
5. Të gjithë antarët e Asamblesë njëftohen nëpërmjet njoftimeve publike në faqen zyrtare të Albautor, nëpërmjet postës elektronike, telefonit etj.
6. Anëtarët, për të cilët është vlerësuar se është drejta e tyre për të marrë informacionin e kërkuar nuk është realizuar, mund t'ia kërkojnë këtë, brenda tri ditëve, komisionit të posaçëm, i përherëshëm në lidhje me shqyrtimin e kërkesës për informim, i emëruar nga mbledhja e përgjithshme, që përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët nuk janë të punësuar dhe nuk janë pjesë e organeve drejtuese. Komisioni është i detyruar t'i përgjigjet, brenda shtatë ditëve, për bazueshmërinë e këtyre pretendimeve, si ankuesit që ka depozituar ankesën edhe drejtuesit të agjencisë.
7. Secili nga anëtarët, nga momenti që ka pranuar statutin, njeh cilësitë që ka Agjencia Albautor për ta përfaqësuar dhe mbrojtur në:

- Çdo proces gjyqësor kundër të tretëve për arsyet e shfrytëzimit të veprave të tij në kuadrin e të drejtave që i ka dhënë Agjencisë
- Çdo proces gjyqësor për personalitetin juridik të Agjencisë apo anëtarëve.

**Neni 5**  
**Organet Drejtuese të Shoqatës**



Organet drejtuese të shoqatës janë:

1. Asambleja e Përgjithshme e Shoqatës.
2. Këshilli i Administrimit;

Presidenti i Shoqatës;

## Neni 6

### Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme e anëtarëve të agjencisë duhet të mblidhet të paktën një herë në

VII;

1. vendos për ndryshimet në statutin e agjencisë
2. vendos për emërimin ose shkarkimin e organeve ekzekutive,
3. rishikon performancën e tyre të përgjithshme dhe miraton shpërblimin e tyre, si dhe përfitimet e tjera, të tilla si përfitimet monetare dhe jomonetare, dhënie pensionesh apo titujsh, të drejta dhe shpërblime të tjera ose të drejtat për pagesa kalimtare;
4. vendos të paktën për politikën e përgjithshme për shpérndarjen e shpërblimeve ndaj mbajtësve të të drejtave dhe shpenzimeve të administrimit të të drejtave
5. vendos për miratimin e çdo blerjeje, shitjeje ose hipoteke të pasurisë së paluajtshme.
6. emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues;
7. pranimin dhe përjashtimin e anëtarëve të Asamblesë;
8. krijimin e komiteteve të posaçme;
9. Antarët e Asamblesë që bëjnë pjesë në këtë Agjenci janë detyrimisht: kompozitorë, kantautorë, autorë teksti, përkthyesh, aranzhatorë, piktorë, fotografë, regjizorë, skenaristë, etj apo dhe krijues të tjërë autorë të cilët kanë lidhur kontratë me agjencinë dhe i kanë kaluar për administrim të drejtat e tyre.

## Neni 7

### Asambleja e Përgjithshme: mënyra e thirrjes dhe mbajtjes së mbledhjeve

- 1) Asambleja e Përgjithshme e agjencisë thirret nga Presidenti i Shoqatës dhe/ose Drejtori, të paktën një herë në vit, dhe në çdo moment për nevoja të posaçme ose kur e kërkon 1/5 e anëtarëve të Asamblesë.
- 2) Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një lajmërimi, dërguar me letër të thjeshtë, ose në mënyrë elektronike të paktën 15 ditë para ditës së mbledhjes dhe i drejtohet të gjithë anëtarëve të Asamblesë. Lajmërimi duhet të përbajë ditën, orën, vendin, fështjet që do të diskutohen si dhe datën e orën e thirrjes së dytë në rast se e para nuk zhvillohet. Thirrja e dytë mund të bëhet në të njëjtën datë me të parën por jo në të njëjtën orë.

- 16
- 1) Asambleja e Përgjithshme konsiderohet e thirrur rregullisht, edhe në rastet kur nuk zbatohen formalitetet për të cilat flitet në paragrin 1) dhe 2) më sipër, në qoftë se janë të pranishëm të gjithë anëtarët.
  - 2) Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mbahen në selinë e shoqatës ose në ndonjë vend tjetër të ndryshëm nga selia, në Shqipëri.
  - 3) Çdo anëtar mund të përfaqësojë një anëtar tjetër mbi bazën e një autorizimi me shkrim ku përcaktohet edhe mënyra e votimit për çështjet në rend të ditës.
  - 4) Asambleja e Përgjithshme drejtohet nga Presidenti i Shoqatës dhe, në mungesë të tij, nga njëri prej anëtarëve i ngarkuar prej tij që është pjesëmarrës i ligjshëm.
  - 5) Asambleja e Përgjithshme, raporton pranë Drejtorisë për të Drejtë e Autorit për cdo mbledhje të saj.
  - 6) Asambleja kryesohet nga Presidenti i Këshillit të Administrimit i Agjencisë Albautor ose, në mungesë, nga Drejtori ose një anëtar i Këshillit të zgjedhur për këtë qëllim nga Presidenti. Byroja e Asamblesë përbëhet nga anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe nga Drejtori i Agjencisë Albautor.
  - 7) Vendimet e Asamblesë të Përgjithshme merren me mazhoritetin relativ ( $50\% + 1$ ) të votave të shprehura.

Asambleja voton zakonisht në mënyrë të hapur, megjithatë votimi i fshehtë nuk përjashtohet kur lind nevoja:

- a) sa herë do ta kërkojë Këshilli i Administrimit;
- b) me kërkesën verbale të paktën të 50 anëtarëve. Këta anëtarë nuk kanë të drejtë të kërkojnë më shumë se dy herë këtë mënyrë votimi gjatë një mbledhjeje të Asamblesë.
- 10) Asambleja proçedon për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Administrimit. Kjo zgjedhje bëhet me mazhoritetin relativ të votave të shprehura. Në rast të barazisë së votave zgjidhen kandidatët që kanë anëtarësinë më të vjetër.
- 11) Vendimet e Asamblesë shkruhen në një procesverbal që nënshkruhet nga Presidenti i Asamblesë ose nga Drejtori i Agjencisë. Ky procesverbal ruhet në një regjistër të vecantë që mbahet në selinë e Agjencisë.
- 12) Gjatë vitit Asambleja e Përgjithshme mund të mblidhen për një objekt të vecantës në bazë të vendimeve të Këshillit të Administrimit dhe me kërkesën e tij.

Neni 8

Dorëheqja

*(Handwritten signature)*

Do anëtar i agjencisë ALBAUTOR mund të japë dorëheqje nga Agjencia, duke iu drejtuar shkrim të paktën gjashtë muaj përpara mbarimit të vitit në vazhdim Presidentit të Këshillit Administrimit dhe Drejtorit të Agjencisë.

Kjo kërkesë për dorëheqje duhet të pasqyrojë:

- 1. arsyet e ligjshme për dorëheqje;
- 2. marrjen përsipër të detyrimeve të tij ndaj Agjencisë si dhe të çdo detyrimi tjetër që vjen si rezultat i shkaktimit të një dëmi të mundshëm ndaj Agjencisë apo marrëdhënieve të Agjencisë me të tretë.

Dorëheqja e dhënë në këtë mënyrë është fakt juridik në mbledhjen e Asamblesë.

Mbajtësit e të drejtave do të kenë të drejtë të zgjidhin autorizimin për të administruar të drejtat e tyre mbi veprën, dhënë prej tyre për agjencinë ALBAUTOR, ose të tërheqin ndonjë prej të drejtave të tyre për të mos u administruar nga Albautor, për vendin e zgjedhur nga ana e tyre, duke bërë njoftimin e duhur, në formë të shkruar, jo më shumë se 6 muaj përpara. Albautor mund të vodosë që një zgjidhje ose térheqje e tillë të hyjë në fuqi vetëm në përfundim të vitit finanziar.

#### Neni 9

#### Përjashtimi

Përjashtimi i një anëtarit bëhet vetëm nga Asambleja e Përgjithshme që vodos me mazhoritetin relativ të votave të shprehura, në rastet kur ka bërë kërkesë Këshilli i Administrimit, kur anëtarit ka bërë shkelje të rënda të Statutit ose në rast se është dënuar gjyqësisht për krim ose delikt ordiner që lidhet me veprimtarinë e Agjencisë ose cënon moralin e saj, kur nuk paraqitet tre herë rresht në mbledhjet e Asamblesë, kur refuzon të deklarojë veprat e tij në fomën audio, video, etj, si dhe kur del haptazi në kundërshtim me interesat e Albautor, apo përfaqësohet nga një entitet tjetër fizik apo juridik në mbledhjen e të ardhurave nga e drejta e autorit.

Asambleja e Përgjithshme mund të vodosë, në rastet e përmendura më sipër ta përjashtojë anëtarin e saj.

Në të gjitha rastet shkelësi do të thirret para Asamblesë së Përgjithshme përmes dhënës shpjegimet e tij për t'u dëgjuar.

#### Neni 10

## Këshilli i Administrimit

Këshilli i Administrimit përbëhet nga 5 anëtarë të zgjedhur midis anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme te autorëve sipas këtyre ndarjeve:

- 2 kompozitorë;
- 1 kantautorë;
- 1 autorë teksti;
- 1 aranzhator.

Anëtarët zgjidhen për një kohëzgjatje prej 4 vjetësh.

Për çdo kategori do të deklarohen të zgjedhur ato që kanë marrë mazhoritetin e zërave.

Anëtarët e Këshillit kanë të drejtën të rizgjidhen.

Këshilli i Administrimit mund të ngarkojë me detyrë të përkohshme (*ad-hoc*) dhe të shpërblyeshme një apo më shumë nga anëtarët e Asamblesë, brenda kompëtencave të tij, në konsultim me Drejtorin e Agjencisë për të drejtuar komisionin e posacëm sipas interesave të shumicës të autorëve anëtarë.

Në rast se një apo më shumë postë në Këshillin e Administrimit mbeten të lira, Asambleja e urdhshme e përgjithshme e agjencisë, vendos në vendet vakante, duke zgjedhur konform statutit, një apo më shumë anëtarë që u përkasin kategorive që mungojnë.

Këshilli i Administrimit ka të drejtë të plotësojë vendet vakante provizorish, me kushtet që përcaktohen në statut. Emërimet, për të cilat ka proceduar Këshilli i Administrimit, i nënshtronen ratifikimit të Asamblesë së Përgjithshme të zakonshme më të afërt.

Çdo anëtar i lajmëruar me shkrim që mungon në tre seanca të njëpasnjëshme, pa arsyte ligjshme, konsiderohet sikur ka hequr dorë nga posti i tij.

Këshilli i Administrimit mblidhet zakonisht çdo tre muaj dhe në raste të veçanta mund të thirret nga njeri prej drejtuesve ose me kërkesën e 1/3 së anëtarëve të tij.

Vendimet e Këshillit të Administrimit merren me mazhoritetin e anëtarëve të pranishëm.

Në rast se votat ndahen përgjysmë ajo e Presidentit ose në mungesë të tij ajo e Presidentit të seancës, është vendimtare.

Proçesverbali i çdo seance dhe vendimet e Këshillit të Administrimit nënshkruhen nga Presidenti, apo/dhe Drejtori. Këto proçesverbale mbahen në një regjistër të posacëm.

Çdo anëtar i Agjencisë me autorizim të Presidentit, mund të lexojë tekstin e proçesverbaleve vendimet, diskutimet e Këshillit të Administrimit në selinë e Agjencisë Albautor.

## Kompetencat e Këshillit të Administrimit

Këshilli i Administrimit zotëron kompetenca për administrimin sa më dobipurës të agjencisë. Si rrjedhojë:

1. Ai vendos politikat e drejtimit të Agjencisë në konsultim me Drejtorin e Përgjithshëm dhe në përgjithësi, të gjithë aktet e administrimit.
2. Ai rregullon marrëdhëniet midis anëtarëve.
3. Ai ratifikon ekzekutimin e marrëveshjeve me përdoruesit e veprave të anëtarëve të Agjencisë.
4. Ai kontrollon mënyrën e mbledhjes së parave, futjen në arkë dhe shpërndarjen e tyre tek anëtarët të Agjencisë.

Këshilli i Administrimit mund t'i japë të drejtë komisioneve të agjencisë të përcaktuar në Rregulloren e Përgjithshme të kontrollojnë butelinet e deklaratave dhe të vendosë klasifikimin e çdo vepre duke aplikuar tabelat e llogaritjeve. Vendimet që merren nga komisionet i nënshtrohen ratifikimit të Këshillit të Administrimit.

5. Këshilli i Administrimit pranon ose refuzon subvensionet, donacionet dhe dhuratat që i bëhen Agjencisë Albautor.

Këshilli i Administrimit në momentin e zgjedhjes së Drejtorit të Agjencisë i ka kaluar atij kredibilitetet për të bërë një menaxhim sa më efikas të Agjencisë Albautor dhe Drejtori është i detyruar të raportojë për administrimin e agjencisë në këtë Këshill.

## Neni 12

### Zgjedhja e Presidentit të agjencisë

Gjatë seancës së parë, pas Asamblesë, Këshilli i Administrimit zgjedh Presidentin e tij. Këshilli i Administrimit nuk mund të proçedoje për këtë zgjedhje pa qenë të pranishëm të paktën 2/3 e anëtarëve që e përbëjnë.

Presidenti zgjidhet me mazhoritetin e anëtarëve të pranishëm.

Presidenti i Këshillit të Administrimit së bashku me Drejtorin e Agjencisë administrative ALBAUTOR-in. Presidenti mund të caktojë nga gjiri i Këshillit të Administrimit një zëvendës që drejton në mungesë të tij.

Presidenti ka të drejtë të rizgjidhet, por nuk mund të ushtrojë veçse dy mandate të njëpasnjëshme.

## Neni 13

## Drejtori i Agjencisë Albautor

Drejtori i Agjencisë zgjidhet nga Këshilli i Administrimit me votë të fshehtë. Ai duhet të ketë kombësinë shqiptare, të ketë jetuar pesë vjetët e fundit në Shqipëri, të jetë jurist dhe i specializuar në fushën e drejtimit, menaxhimit dhe administrimit kolektiv të pronësisë artistike. Ai nuk duhet të ketë konflikt interes i ushtrimin e deyrës së tij si drejtor i Agjencisë.

Ai zgjidhet dhe shkarkohet me të paktën 2/3 e votave të anëtarëve të Këshillit të Administrimit.

Ai është shefi i shërbimeve administrative dhe i personelit të Agjencisë dhe i punësuar sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Drejtori emëron dhe shkarkon personelin administrativ të Agjencisë.

Atij i është ngarkuar të sigurojë dhe të ndjekë ekzekutimin e vendimeve të Këshillit të Administrimit dhe, nën drejtimin e kontrollin e këtij të fundit, të sigurojë në mënyrë të përgjithshme administrimin e Agjencisë të cilën ai e drejton dhe mbikqyr në të gjitha shërbimet.

### Neni 14

#### Detyrat e Drejtorit të agjencisë

Drejtori i Agjencisë ka për detyrë:

1. Të mbajë shkrimet, llogaritë dhe korrespondencën e Agjencisë.
2. Të sigurojë mbledhjen e të drejtave e recetat e tjera dhe të mbajë llogarinë bankare të Agjencisë.
3. Të sigurojë rregulloren e shpenzimeve që rrjedhin nga nevoja e funksionimit të Agjencisë.
4. Të përgatisë shpërndarjen e të ardhurave për anëtarët e agjencisë dhe për ata që u kanë kaluar të drejtat dhe t'ia paraqesë Këshillit të Administrimit për t'i aprovuar.
5. Të nisë procese gjyqësore civile, penale, administrative apo arbitrazhi, të ndjekë vetë ose të vendosë një përfaqësues ligjor në çdo proces gjyqësor për mbrojtjen e anëtarëve të Agjencisë, të personalitetit juridik të Agjencisë si dhe të ndjekë ekzekutimin e tyre, të arrinë marrëveshje jashtëgjyqësore apo të heqë dorë nga ato.

Drejtori i Agjencisë merr pjesë në të gjitha mbledhjet e asamblesë. Ai asiston në Këshillin e Administrimit si dhe në seancat e këshillit në fjalë.

Ai mund të asistojë në mbledhjen e komisioneve të parashikuara të krijuara sipas statutit. Drejtori i Agjencisë nuk ka të drejtë vote në Asamble, në Këshillin Administrativ apo në komision, kur asiston në mbledhjet e tyre.

Neni 15

## Administrata e Agjencisë

Anëtarët e personelit të agjencisë duhet të gjelqojnë të drejtat e tyre si punonjës. Ata nuk mund t'i jenë dhe as mund të bëhen anëtarë të agjencisë. Personelit i ndalohet të ketë të drejta mbi veprat e mbrojtura nga Agjencia dhe të pranojë të drejta që mund t'u bien në pjesë me instrument nga të gjallët për shkak të ushtrimit të detyrës.

Ata ndalohen të hyjnë në bisedime apo në marrëveshje direkt apo indirekt me përdoruesit e veprave të repertorit të Agjencisë dhe në të gjitha veprimet që mund të vijnë kundër interesave të Agjencisë.

Neni 16

## Njësítë e administrimit të Agjencisë

Njësítë e administrimit të Agjencisë janë:

- 1- Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm;
- 2- Zyra Juridike dhe e marrëdhënieve me Jashtë;
- 3- Zyra e Financës dhe e Shpërndarjes;
- 4- Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe e Protokollit.

• Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm është zyra e cila përfaqëson veprimtarinë ekzekutive të Agjencisë. Ajo drejtohet prej Drejtorit të Përgjithshëm. Veprimtaria e saj bazohet në parashikimet e Statutit dhe në legjislacionin e R.SH.

• Zyra Juridike dhe e marrëdhënieve me Jashtë është zyra e cila autorizohet prej Drejtorit të Përgjithshëm për të kryer gjithë veprimtarinë juridike të Agjencisë. Në Drejtorit të Përgjithshëm për të kryer gjithë veprimtarinë juridike të Agjencisë. Në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm vendos përmarrëdhëniet me shoqëritë e huaja simotra në fushën e të drejtës së autorit. Kjo zyrë mban raportet e agjencisë me huaja simotra në fushën e të drejtës së autorit. Ajo drejtohet shoqëritë e huaja, me organizatat ndërkombëtare për të drejtën e autorit. Ajo drejtohet prej një juristi me një eksperiencë pune jo më pak se tre vjet i cili është i punësuar në Agjenci, ose nga vetë Drejtori i Përgjithshëm.

• Zyra e Financës dhe Shpërndarjes është zyra e cila vepron përmë mbajtur të gjitha të dhënat financiare të Agjencisë, përmë kryer të gjitha pagesat, përmë mbajtur logjistikë, dëshmorët, informacionin e nevojshëm përmë shpërndarjen e produktit finanziar. Ky dëshmorët mundëson informacionin e nevojshëm përmë shpërndarjen e produktit finanziar. Ky informacion është përmë zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm. Vetëm ai mund të lejojë çdo person të interesuar përmë këtë informacion me anë të një urdhëri me shkrim, pa rënë

në kundërshtim me këtë Statut dhe me legjislacionin në R.SH.

- Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Protokollit është zyra e cila mban marrëdhëniet me autorët, përdoruesit si dhe kujdeset për imazhin e Albautor. Protokolli është institucioni i cili ruan, mbledh dhe shpërndan me urdhër të Drejtorit të gjithë informacionin e nevojshëm që nxjerr dhe vjen në agjenci. Kjo zyrë vepron në zbatim të urdhërave të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm.

### Neni 17

Pranë Agjencisë mund të krijohet një komitet juridik, i cili shpreh mendimin e tij, për të gjitha çështjet juridike që kanë të bëjnë me agjencinë dhe me anëtarët e saj. Ai emërohet nga Këshilli i Admistrimit me propozim të Drejtorit të Agjencisë.

### Neni 18

#### Detyrimi i agjencisë Albautor për publikimin e informacionit

Agjencia Albautor ka detyrimin për të publikuar, në format elektronik, në faqen e saj të internetit, informacionin e përditësuar ~~si~~ më poshtë: a) statutin; b) listën e anëtarëve të organeve qendrore dhe vendore të ~~administrimit~~, përbërjen e komisioneve të brendshme dhe listën e administratorëve lokalë; c) deklaratën vjetore në lidhje me bilancin e shumave jo të shpërndara, shumat e mbledhura nga ~~kategoritë~~ e përdoruesve ose paguesve, shumat e mbajtura në burim, koston e ~~administrimit~~ dhe shumat e shpërndara nga ~~kategoritë~~ e pronarëve/autorëve; ç) raportin vjetor; d) informacion për asamblënë e përgjithshme, për shembull: datën, vendin e thirrjen, agjendën, projektvendimet dhe vendimet e miratuar; dh) të dhëna të tjera të nevojshme për anëtarët, për qëllime informimi.

### Neni 19

#### Shkrirja

Agjencia nuk mund të shkrihet për shkak të vdekjes, ndalimit, vënies nën ndjekje gjyqatore, falimentimit, shkatërrimit, përjashtimit, dorëheqjes së njerit apo disa prej anëtarëve të Agjencisë. Ajo do të vazhdojë me anëtarët e tjere.

### Neni 20

#### Likuidimi

Pas mbarimit të kohëzgjatjes së afatit të Agjencisë apo në rast të një shpërndarje të

(22)  
sakohshme të saj, Asambleja e Jashtëzakonshme, me propozim të Këshillit të Administrimit, rregullon mënyrën e likuidimit dhe emëron një ose disa likuidues të cilëve u përeakton pushtetet.

Asambleja e Përgjithshme ruan, gjatë likuidimit të gjitha atributet që ka gjatë kohës së funksionimit të Agjencisë. Ajo ka veçanërisht pushtetin për të aprovuar llogaritë e likuidimit.

### Neni 21

Çdo nen i statutit të ALBAUTOR që vjen në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe në veçanti me ligjin për të drejtën e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të nr. 35/2016, ashtë i pavlefshëm dhe do të zbatohet vetëm ligji, për shkak të parimit ligjor që Ligji ka fuqi mbi Statutin.

### Neni 22

#### Personaliteti Juridik i Agjencisë

Agjencia gëzon personalitet Juridik që nga dita e regjistrimit të saj të parë në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë në vitin 1992 dhe riregjistimeve të bëra sipas legjislacionit për të drejtën e autorit dhe të legjislacionit në fuqi në R.SH.

### FUND

